

V E N D I M
Nr. 113, datë 19.3.1991

PËR PËRDORIMIN NGA SHTETASIT TË AUTOMJETEVE PRIVATE

Me propozimin e Ministrisë së Transporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të lejohet përdorimi i mjeteve automobilistike private nga çdo shtetas që është i pajisur me dëshminë përkatëse të drejtimit të mjetit.

2. Ndërmarrjet shtetërore të sistemit të Ministrisë së Transporteve që disponojnë autovetura për shërbimin e udhëtarëve, lejohen t'ua shesin ato shoferëve të tyre për t'i përdorur si taksi private në shërbim të popullit.

Gjithashtu ndërmarrjet dhe institucionet lejohet të shesin automjete, motorçikleta e triçikle personave nëpërmjet njësive të ndërmarrjeve të tregtimit të pjesëve të ndërrimit. Kriteret e caktimit të çmimeve dhe rregullat e shitjes miratohen nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Industrisë Mekanike dhe Ministrinë e Transporteve.

3. Shitja e automjeteve, motorçikletave e triçikleve të reja e të përdorura nga importi dhe e pjesëve të ndërrimit për to të bëhet nga njësitë e organizuara nga ndërmarrja e tregtimit të pjesëve të ndërrimit në vartësi të Drejtorinë e Përgjithshme të Industrisë Mekanike.

4. Shtetasit që do të kenë në përdorim mjete private, mund t'i përdorin ato për taksi ose shërbime të tjera për popullin, si dhe organizohen në kooperativa transporti.

5. Riparimi i mjeteve të personave privatë të bëhet në pikat që do të hapë e organizojë Ministria e Transporteve.

6. Drejtoria e shpërndarjes së karburanteve të marrë masa për organizimin e shitjes së karburantit për persona privatë.

7. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Transporteve të marrin masa për krijim e kushteve për pajisjen e shtetasve me dëshmi aftësie për drejtimin e mjeteve. Për këtë qëllim të nxjerrin udhëzime për organizimin e kurseve për të gjitha llojet e dëshmisë së aftësisë, si dhe për marrjen në provë, kundrejt pagesës së qytetarit, krahas aftësimit në mënyrë individuale të kandidatit për dëshmi aftësie, sipas rregullave të parashikuara me dispozita të veçanta.

8. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.129, datë 6.4.1985 "Për mbrojtjen e rrugëve dhe qarkullimin rrugor", në nenin 95, në shkronjën "ç" hiqen fjalët ("kjo dëshmi është e pavlefshme për ushtrimin e mjeshtërisë së shoferit").

9. Ministria e Financave, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, të caktojë çmimet me pakicë për riparimet, pjesët e ndërrimit, karburantet etj, që do t'u shiten personave privatë.

10. Organet e qarkullimit rrugor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për regjistrimin e mjeteve private dhe për pajisjen e tyre me targë njohjeje dhe leje qarkullimi, përveç kërkesave të tjera ligjore, kërkojnë nga shtetasi dokumentimin e pronësisë mbi mjetin ose çdo dokument tjetër të njesuar me të, si dhe të paguajnë një taksë regjistrimi në masën që caktohet nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Transporteve. Kjo taksë nuk zbatohet për mjetet që janë regjistruar para daljes së këtij vendimi.

11. Organet e policisë popullore dhe organet e kontrollit të shfrytëzimit të mjeteve të transportit, kur vërejnë që shtetasit që kanë mjete private i kanë furnizuar ato me karburant ose i kanë riparuar me pjesë ndërrimi të shtetit pa bërë pagesën përkatëse dhe kur ato veprime nuk përbëjnë vepër penale, urdhërojnë pagimin e vlerës së karburantit të konsumuar ose të riparimit të kryer. Urdhri i shefit të seksionit të kontrollit të qarkullimit rrugor dhe të kryetarit të degës së kontrollit të shfrytëzimit të mjeteve është titull ekzekutiv.

12. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.290, datë 16.3.1983 "Për ndalimin e tjetërsimit

të automjeteve dhe për shitjen, riparimin e furnizimin me karburante e lubrifikante të motoçikletave e triçiklave në pronësi vetjake", shfuqizohet.

13. Ministria e Financave, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore të interesuara, të nxjerrin udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
FATOS NANO